



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2650, datë 03.12.2015

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone Albania sh.a kundër Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr. 2617 dhe Nr. 2619, datë 08.10.2015”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar
5. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 03.12.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone Albania sh.a kundër Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr. 2617 dhe Nr. 2619, datë 08.10.2015”

BAZA LIGJORE:

- 1) Nenet 31 e në vijim i Kreut VI të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (ligji nr. 9918);
- 2) Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” i ndryshuar (ligji nr. 8485);
- 3) Rregullore për analizën e tregut, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e

- ndryshuar;
- 4) Udhëzues për Procedurat e Këshillimit me Publikun miratuar me VKD nr.1183, datë 10.03.2010.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit (*Relacioni*),
2. Ankimi administrativ i sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a kundër Vendimeve të Këshillit Drejtues nr. 2617 dhe 2619 të datës 08.10.2015, dërguar me shkresën Nr.2014 Prot., datë 10.11.2015.
3. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP me Vendimin Nr. 2617, datë 08.10.2015, miratoi dokumentin “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokument Përfundimtar*” dhe me Vendimin nr. 2619, datë 08.10.2015 miratoi “*Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese për shërbimet e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjet fikse*”. Miratimi i dokumenteve u krye pas procesit të këshillimit publik, gjatë së cilës AKEP mori në konsideratë komentet e dërguara nga palët e interesuara.
2. Vodafone Albania sh.a. me shkresën me Ref. LRD/0149/OX, datë 06/11/2015, “*Ankim administrativ*” (Referenca e AKEP: Nr.2014 Prot., datë 10.11.2015) ka depozituar ankim administrativ kundër Vendimeve Nr. 2617 dhe nr.2619, datë 08.10.2015 të KD të AKEP. Ankimi i Vodafone Albania është kryer brenda afateve të përcaktuara nga Kodi i Procedurave Administrative.
3. Vodafone Albania në akim shprehet se pas shqyrtimit të akteve administrative, gjykon se Vendimi nr. 2617 dhe per rrjedhojë edhe Vendimi 2619, kanë përcaktuar përfundime që janë në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator ekzistues, kanë vendosur masa të papërshtatshme për kushtet e konkurrencës, joproportionale dhe që nuk gjejnë mbështetje në kuadrin rregullator dhe praktikën europiane. Vodafone kërkon revokimin e pjesshëm të dy akteve që çenojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë konkurrencës në treg dhe subjektin e tyre, duke argumentuar si më poshtë.
 - 3.1. **Percaktimi i tregut të pakicës në lidhje me aksesin dhe thirrjet nga një vendndodhje fikse bie ndesh me kuadrin Ligjor ekzistues dhe praktikën me**

te mire Europiane duke i hapur rruge diskriminimit te njeanshem ne favor te operatorit Albtelekom.

Neni 32 i Ligjit 9918 parashikon se AKEP në procesin e përcaktimit të tregut duhet të zbatohet parimet e këtij ligji, të ligjit për konkurrencën dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian për këtë qëllim;

- A. Vodafone shprehet se, qasja e AKEP për të përfshirë në një treg të vetëm pakicë aksesin dhe thirrjet nga vendndodhje fikse me aksesin dhe thirrjet nga rrjeti celular bie ndesh me parimet e përcaktimit të tregut (parimi i zëvendësueshmërisë) të përcaktuar qartë në Udhezimin e Autoritetit të Konkurrencës nr. 76/2008 "Për përcaktimin e tregut perkates". AKEP nuk ka shqyrtuar zëvendësueshmërinë nga ana e kërkesës, nuk ka marrë në konsideratë karakteristikat e produkteve të pretenduara si në të njëjtin treg, mungon pikeveshtrimi i konsumatoreve, nuk është realizuar testi SSNIP, etj.

Sipas Vodafone, nuk ka zëvendësueshmëri sespe janë zëvendësueshmëri asimetrike, pasi aksesin nga rrjetet celulare nuk është i zëvendësueshmë me me atë në rrjet fikse. Mbulimi dhe cilesia e thirrjeve në rrjet celulare varion në zonë dhe në kohë të ndryshme.

- B. Vodafone shprehet se, qasja e AKEP për përcaktimin e tregut perkates bie ndesh me praktikën rregullatore në BE dhe rajon dhe asnjë organ rregullator nuk e ka pranuar një ri-përcaktim të këtij tregu. Me pas Vodafone vijon të referohet një dokumeti të BEREC mbi FMS, mbi të cilin është bazuar për të bërë argumentimin e qëndrimit të tij edhe gjatë këshillimit publik të analizës. Gjithashtu Vodafone i referohet edhe Rekomandimit 710/2014, i cili nuk e sheh FMS (fix mobile substitution) si një realitet, por shprehet se produktet janë plotësues të njëri-tjetrit dhe jo zëvendësues.
- C. Të gjithë analizat dhe argumentat ekonomike, nëse zbatohen në mënyrë korrekte, provojnë se aksesin/thirrjet nga telefonat celulare nuk duhet të përfshihen në të njëjtin treg pakicë me aksesin/thirrjet nga vendndodhjet fikse, vijon argumentimin Vodafone. AKEP nuk ka marrë në konsideratë faktorët që liston BEREC mbi këto çështje. Mes tyre përmendin; 1) Diferencat mes ofertave të fiksit dhe celularit; 2) Struktura e tregut; 3) Analiza e ofertave bundle; 4) Krahasimi i numrit dhe menyrave të aksesit; 5) Vlerësimi nëse shërbimet televizive mund të përdoren nëpërmjet rrjeteve celulare; 6) Zëvendësueshmëria historike dhe potenciale ndërmjet rrjeteve celulare dhe fikse; 7) Ndryshimet mes pajisjeve fundore; 8) Ndryshimet mes karakteristikave të përdoruesve fundore dhe përdorimit të shërbimit; 9) Ekzistenca mes ofertave promovionale për shërbime/rrjete të vecanta; 10) Problematikat specifike të rrjetit të shpërndarjes; 11) Kenaqësia e përdoruesit fundor ndaj secilit prej shërbimeve.

D. Sipas Vodafone, qasja e AKEP bie ndesh me gjetjet e Autoritetit te Konkurrences. Ne Vendimin 303/2014, rikonfirmuar dhe nga Vendimi 366/2015, Autoriteti i Konkurrences shprehet qartazi se sherbimet e telefonise fikse nuk jane ne te njejtin treg me ato te telefonise celulare, nderkohe qe perfundimet e AKEP bie ndesh me te.

3.2. Percaktimi i fuqise se ndjeshme ne tregun e pakices per operatorin Albtelekom (fiks) nuk eshte i sakte dhe bie ndesh me kuadrin ligjor dhe praktikat me te mira, duke e favorizuar ate ne menyre te padrejte.

Neni 33 i Ligjit 9918 dhe Neni 8 i Ligjit 9121/2003 parashikojne se per te bere vleresimin e sipermarresve me fuqi te ndjeshme ne treg, AKEP-i duhet te bazohet ne disa faktore te cilet i sqaron me ne detaje dhe per te cilat ngre pretendimin se AKEP nuk i ka marre ne konsiderate.

Nga ana tjeter, mos shpallja e Albtelecom si operator me fuqi te ndjeshme ne tregun me pakice te telefonise favorizon dukshem kete operator, i cili me heqjen e rregullimit paraprak nga AKEP ka mundesine te abuzoje me poziten e tij dominuese i pashqetesuar nga presioni rregullator, sic edhe ndodhi 1 vit me pare mbas derregullimit te tarifave te pakices. Favorizimi cenon njekohesisht te gjithe operatoret e telefonise celulare, perfshire Vodafone, pasi Albtelecom eshte i vetmi operator i integruar ne te dy tregjet fiks dhe celular.

3.3. Tarifat e terminimit nuk jane te orientuara ne kosto dhe si te tilla jane ne shkelje te Legjislacionit shqiptar, rekomandimeve dhe praktikave te BE dhe gjenerojne inefficenca tregu ne dem te pajtimtareve.

1. Vodafone pretendon se, AKEP eshte i detyruar qe pergjate rregullimit te tarifave t'i orientoje ato ne kosto, cka nuk ka ndodhur me tarifate e operatorit Albtelecom, duke rene ne kundersiztim me nenin 55/4 te Ligjit 9918. Edhe vete AKEP, pohon Vodafone se e ka pranuar se tarifa e terminimit (FTR) e akorduar incumbent-it eshte pertej cdo statistike ne nivel European dhe si e tille bie ndesh me nenin 57/2/a. b, c, te Ligjit 9918. Me pas Vodafone vijon me disa statistika referuar Cullen International ne lidhje me modelin e kostove dhe nivelin e FTR. Konkretisht, sipas Vodafone, AKEP imponon per Albtelecom nje FTR prej rreth 1 Eurocent/min nga Janari 2016, shume here me e larte se FTR i orientuar ne kosto, dhe disa vite e sfazuar nga afati i detyruar per implementim, i cili sipas Rekomandimit ka qene Dhjetor 2012. Ne kushte kur MTR jane orinetuar ne kosto, qasja e ndryshme per FTR diskriminon operatorin incumbent Albtelecom kundrejt operatoreve te tjere, aq me teper ne nje treg te integruar me sherbime fiks+mobile sic eshte rasti per Albtelecom dhe Eagle apo sic AKEP e konsideron tregun e pakices (treg i perbashket per thirrjet dhe aksesin nga telefonia celulare dhe fikse). Vodafone pretendon se kjo perben shkelje te parimit te 'mosdiskhminimit', percaktuar ne nenin 7 te Ligjit 9918:

2. Mosorientimi i FTR ne kosto pure LRIC bie ndesh me Rekomandimin perkates dhe praktiket europiane. Bazuar ne sa me kane argumentuar per kete ceshtje me ne detaje ne akimin e sjelle, Vodaofne sqaron se, duke qene se pjesa qendrore e rrjetit fiks Albtelecom eshte tashme e bazuar plotesisht ne NGN, pra operon me nje teknologji efciente, plotesohen teresisht kushtet per te kryer nje analize te metodologjise se koston FTR sipas kostove te nje operatori efcient per operatoret e telefonise fikse. Cdo qasje e ndryshme, perfshire zbatimin i metodet benchmarking, eshte ne kundertshti me Rekomandimin dhe praktiket e vendeve te BE. Per te mbeshtetur me shume ate cfare pretendon Vodafone i referohet nenit 16/1 te Rekomandimit dhe nenit 7 te Ligjit 9918, i ndryshuar.
3. Vodafone shprehet se, niveli aktual i FTR perben diskriminim ndaj operatoreve celulare. Niveli i FTR se bashku me glidepathin e miratuar nga AKEP diskriminon negativisht operatoret celulare, pasi nuk reflekton ne menyre korrekte koston qe mbartin operatoret fikse perkundrejt atyre celulare. Vodafone e bazon kete argument duke sjelle grafikisht edhe "EU MTR/FTR differential".
4. Vodafone po ashtu, shpjegon se tarifat jo te orientuara ne kosto gjenerojne ineficensa ne dem te tregut dhe konsumatoreve. FTR mbi kosto shkakton ineficence dhe kjo bie ne kundertshti me nenin 7 te Ligjit 9918, pasi AKEP ka si objektin rregullator te promovojte efcencen ne treg. FTR pertej kostove siguron nje subvencion te pandershem, qe perkthehet ne ineficence te nje kompanie e cila legjitimohet te mbledhe te ardhura te pamertuara ne treg, pa qene nevoja qe te permiresojte performancen e saj financiare dhe operacionale.
5. Zbatimin i FTR mbi kosto nuk mbrohet nga asnje argument ekonomik. Vodafone sqaron se koston e rrjetit jane gjithmone me te larta per operatoret celulare pasi lidhen ngushtesisht me rrjetin e aksesit cka rrjedhon ne diferencen e madhe ne strukturen e kostove mes rrjeteve fikse dhe celulare sic edhe e reflekton praktika e BE.

3.4. Në përfundim, të gjithë sa më sipër parashtron, Vodafone Albania sh.a., kërkon nga AKEP:

- Pranimin e ankimit administrativ;
- Revokimin pjesërisht të VKD nr. 2617, datë 08.10.2015, për "Per "Miratimin te Dokumentit: Analize e tregut telefonise fikse: tregjet me pakice dhe tregjet me shumice te terminimit tranzitimit dhe origjinimit - Dokument Perfundimtar" per pjesen qe ka percaktuar se tregjet e aksesit dhe te thirrjeve nga vendndodhje fikse jane ne te njejtin treg me aksesin dhe thirrjet nga rrjetet e levizshem; percaktimin e Albtelekom si operator me fuqi jo te ndjeshme ne tregun e pakices; niveli i tarifave te reja te terminimit dhe glide path perkates;

- Revokimin e pikes 3.5, nenpika III dhe nenpika 6 te Vendimit N.2619, date 08.10.2015 ""Percaktimin e sipermarresit Altelecom Sh.a., me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese per sherbimet e terminimit dhe tranzitimit te thirrjeve ne rrjet fikse"" ne lidhje me tarifat e reja te terminimit dhe heqjen e detyrimeve FNT ne tregun e pakices te thirrjeve telefonike dhe aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse;
4. AKEP pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën dhe argumentet e Vodafone Albania dhe vlerëson se pretendimet e ngritura janë adresuar dhe trajtuar qartë në dokumentin e Analizës dhe Aneksin nr.2, në qendrimet e AKEP ndaj komenteve të dërguara gjatë këshillimit publik.
- I. Ne lidhje me përcaktimin e tregut të pakices me akses dhe thirrjet nga vendodhje fikse me aksesin dhe thirrjet nga rrjeti AKEP ka ndjekur dhe përdorur të gjitha procedurat dhe rekomandimet qe janë në fuqi për këtë qëllim dhe ka analizuar më hollësisht cdo pretendim te Vodafone Albania në dokumentin e Analizes. Përsa i takon Udhezimit të Autoritetit të Konkurrencës AKEP ka dhënë përgjigje që në procesin e këshillimit, se ky Autoritet ka vlerësuar se dokumenti ka adresuar drejt çështjen e konkurrencës dhe se ndërmarrja “Altelecom” ka rënie të pjesëve të tregut, duke u ndeshur me konkurrencë të operatorëve te tjere. AKEP ka dhënë njëkohësisht refernca nga dokumneti i KE për përkufizimin e tregjeve përkatës dhe faktorëve specifike të vendit që duhet të merren ne konsideratë në zëvendësueshmërine fikse-celular.
- II. AKEP bazuar në zhvillimet e tregun të pakicës së aksesit dhe thirrjeve nga vendodhje fikse të Altelecom, de-rregullimi i tarifës me pakicë që në vitin 2014 dhe faktorë të tjerë për të cilët AKEP është ndalur më gjatë në Analizë, gjykon se Altelecom nuk përmbush kriteret për tu shpallur me fuqi të ndjeshmë në këtë treg. Dokumenti i analizës së tregut ka trajtuar gjerësisht faktorët që ndikojnë ose jo në pozitën e Altelecom në tregun me pakicë, bazuar në kushtet reale të tregut Shqiptar.
- III. Lidhur me tarifat e terminimit ne rrjete fikse AKEP, ka sqaruar në dokumnetin e analizës së tregut se kjo zgjedhje e AKEP është bazuar në karakteristikat e tregut fikse në Shqipëri:
- telefonia fikse ka zhvillim (mbulim dhe përdorim) shumë më të ulët se në vendet e rajonit dhe BE, ndërsa telefonia celulare në Shqipëri ka shumë më tepër karakteristika të ngjashme me vendet e rajonit dhe BE. Këto karakteristika ndikojnë në nivelin e kostove duke cuar në kosto më të larta për njësi në Shqipëri per rrjetet fikse, ndërsa janë të ngjashme për rrjetet celulare në raport me vendet e rajonit dhe BE;

- objektivi për të rritur stimujt për investime/modernizime në rrjete fikse, jo vetëm për telefoni fikse por sidomos për akses broadband fikse.

Ky konkluzion i AKEP është arritur nga analiza e një sërë treguesve krahasimorë të tregut të telefonisë fikse dhe celulare në Shqipëri dhe në vendet e BE, të trajtuara në analizën e tregut fikse si dhe në atë të tregut celular.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S:

1. Të mos pranojë ankimin administrativ të Vodafone Albania kundër Vendimeve të Këshillit Drejtues Nr. 2617 dhe 2619, datë 8.10.2015, depozituar me shkresën me Ref. LRD/0149/OX, datë 06/11/2015.
2. Të njoftohet Vodafone Albania sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARË:

Z.Alban KARAPICI

Znj.Anila DENAJ

Znj.Klarina ALLUSHI

Znj.Ketrin TOPCIU